



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 03/09**

**Prishtinë, më 15.12.2009, ora 10:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**  
**nga mbledhja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike**

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Haki Shatri, Safete Hadërgjonaj, Kosara Nikolić, Arsim Rexhepi, Anita Morina, Sinavere Rysha dhe Enis Kervan, Riza Smaka.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Gani Koci (me leje)**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Vilson Ukaj,** dhe stafi i KIPRED në përkrahje të Komisionit (**Artan Venhari dhe Qemajl Marmullakaj**).

Prezent: **Miranda Shala** nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, monitorues Zyra e Presidentit të Kosovës, **OSCE** dhe **KDI**.

**Kryesues: Haki Shatri, Kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara dt. 01.12.2009;**
- 3. Aprovim i Draftit të Mandatit të Komisionit;**
- 4. Dëgjim mbi funksionimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;**
- 5. Të Ndryshme.**

### **1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 01.12.2009;**

Procesverbali u miratua më vërejtjet dhe ndryshimet e kërkuara nga Kryesuesi për përfshirjen e përfaqësueses së Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në procesverbal.

### **3. Aprovim i Draftit të Mandatit të Komisionit;**

**Kryesuesi**, propozoi që draftit të mandatit të prezantuar dhe diskutuar nga anëtarët e komisionit të shqyrtohet pasus pas pasuesi në mënyrë që të kemi një draft të unifikuar dhe pastaj të procedojmë me të në instancat tjera të Kuvendit.

Debati kryesorë gjatë shqyrtimit të draft mandatit është fokusuar në pikën (4), gjegjësisht në përbërjen dhe anëtarësinë e Komisionit.

**Arsim Rexhepi**, propozon që njëri nga anëtarët e partive apo grupeve politike jo shumicë të përfaqësuar në Kuvend të jetë nga partitë apo grupet në opozitë.

**Enis Kervan**, propozoi që të hiqen nga teksti pjesët ku thuhet “partitë apo grupet opozitare” dhe të ndërrohet me “grupet parlamentare në opozitë” me shpjegimin që në bazë të rregullores së punës së Kuvendit, vetëm grupet parlamentare kanë të drejtë të dërgojnë përfaqësues në komisione.

**Kryesuesi**, të gjithë anëtarët e komisionit janë dakordua në parim që numrat e komisionit të jenë katër (4) nga opozita dhe pesë (5) nga pozita. Vetëm të gjendet forma se si të vihet deri të këta numra. Propozoi që, duke pasur parasysh që njëri nga anëtarët e grupeve parlamentare jo shumicë nuk mundë të jetë nga partitë opozitare, atëherë njëri nga anëtarët e grupeve në pozitë të hiqet dhe të ndërrohet me ndonjë anëtarë në opozitë.

**Sinavere Rysha**, meqë ky komision është për ta kontrolluar menaxhimin e financave publike të pozitës nga opozita, dhe meqë njëri nga anëtarët e grupeve jo-shumicë nuk mundë të jetë nga opozita, atëherë propozoi që dy anëtarë të grupeve në pozitë të heqin dorë nga ky komision në mënyrë që të bëhet balancimi.

**Arsim Rexhepi**, Iniciativa e kryesuesit dhe e Sinavere Ryshës u refuzua në bazë të vendimit të kryesisë së Kuvendit dhe bazuar në proporcionin e përfaqësimit të partive politike në Kuvend. Dhe nëse për hir të mirëfunksionimit të komisionit propozoi që të kërkohet shtimi i numrit të anëtarëve të komisionit nga nëntë (9) në njëmbëdhjetë (11) anëtarë dhe të jenë nga opozita. Dhe se jo çdo gjë që ka të bëjë me buxhetin duhet të i besohet opozitës.

**Riza Smaka**, propozoi që opozita duhet të dominoj me një anëtarë.

**Enis Kervan**, propozoi që të mbetet me nëntë deputet dhe meqë për momentin nuk kemi anëtarë të komisionit nga komunitetet jo shumicë nga radhët e opozitës. Prandaj, ne duhet ta lemë ashtu si është pasi që edhe anëtarët e PDK nuk janë prezent dhe se numri është vendim i Kuvendit.

**Kryesuesi**, propozoi që pjesa opozitare e komisionit propozoi kështu, ndërsa pjesa e pozitës propozoi të mbetet siç është. Pastaj mbetet tek kryesia të gjejë vendimin e duhur dhe të vendosë.

**Kosara Nikolić**, propozoi që të mbetet ashtu siç është dhe ne të fokusohemi në funksionalitetin e komisionit.

#### **Propozimet e Komisionit për pikën (4) paragrafi (c) të draft mandatit të KMFP-së.**

1. Njëri nga anëtarët e komisionit nga radhët e komuniteteve jo-shumicë të jetë nga grupet parlamentare opozitare, që të bëhet balancimi i komisionit me 4 anëtarë nga opozita (përfshi edhe kryetarin e komisionit) dhe 5 anëtarë nga grupet në pozita;
2. Të rritet numri i anëtarëve të komisionit nga nëntë (9) në njëmbëdhjetë (11) dhe të reflektoj numrat gjashtë (6) nga pozita dhe (5) nga opozita;
3. Numri i anëtarëve të komisionit të jetë pesë (5) anëtarë nga grupet parlamentare të opozitës dhe katër (4) nga grupet parlamentare të pozitës.
4. Të mbetet ashtu siç është.

Paragrafi (d) i pikës katër (4) të draft mandatit të KMFP-së

**Kryesuesi**, bazuar në draft mandatin e propozuar të komisionit propozoi që jo më shumë se ½ e anëtarëve të KMFP-së të jenë edhe anëtarë të KBF-së. Po ashtu bëri vërejtjen që së paku kryetarët e komisioneve të mos jenë edhe anëtarë të komisioneve respektive, si dhe ofroi dorëheqjen nga komisioni për Buxhet dhe Financa.

**Riza Smaka**, e përkrahi idenë e kryesuesit dhe tregoi që edhe ai ka dhënë dorëheqjen nga KBF.

**Anita Morina**, përkrahi qëndrimin e kryesuesit me arsyetimin se të qenit anëtarë të këtyre dy komisioneve është konflikt interesi.

**Safete Hadergjona**j, shprehi gatishmërinë që të mos jetë pjesë e cilitdo komision në mënyrë që të funksionalizohet ky komision, por nuk e sheh arsyetimin pse duhet të jetë problematike kjo punë. Mirëpo nëse kërkohet një gjë e tillë atëherë kjo të jetë praktikë edhe për komisione tjera.

**Arsim Rexhepi**, përkrahi idenë që një anëtarë i KMFP-së të mos jetë anëtarë i KBF-së e me theks të veçantë që kryetarët të mos jenë pjesë e këtyre dy komisioneve.

**Sinavere Rysha**, propozoi që asnjë anëtarë i këtyre dy komisioneve të mos jenë anëtarë në të dyja komisionet.

**Kryesuesi**, theksoi që duke dëgjuar debatin 5 nga 8 mendojnë që është konflikt interesi të qenit anëtarë si në komisionin për Buxhet dhe Financa dhe në komisionin për Mbikëqyrje të Financave

Publike. Meqë komunitetet jo shumicë nuk kanë mundësi për shkak të numrave të anëtarëve nuk mundë ta cungojmë në tërësi mospjesëmarrjen në të dyja komisionit. Prandaj propozoi që kryesisë ti shkoj propozimi si vijon:

#### **Propozim për paragrafin (d) të pikës katër (4) të draft mandatit të KMFP-së**

- Shumica e anëtarëve të Komisionit të pranishëm mendojnë që është konflikt interesi të qenit anëtarë në të dyja komisionet (KBF dhe KMFP);
- Një pjesë e anëtarëve të komisionit mendojnë që nuk është konflikt interesi;
- Kryesuesit e asnjërit nga komisionet të mos jenë anëtarë në të dy komisionet (KBF dhe KMFP).

Për informata më të hollësishme për amandamentimet në draft mandat të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, shih Shtojcën I të procesverbalit.

#### **4. Dëgjim mbi funksionimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm**

**Kryesuesi**, Kemi komunikuar me Auditorin Gjeneral z. Olofsson të cilin e kemi ftuar për ta dëgjuar për çështjet që e preokupojnë Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm për kryerjen e auditimeve të cilat i ka për obligim ligjorë.

**Lars Lage Olafsson**, foli për planet e tij gjatë mandatit 5 vjeçar të cilat janë themelimi i një Zyre Kombëtare të Auditimit, si anëtare e institucioneve ndërkombëtare të auditimit në përputhje me INTOSAI, sipas praktikave më të mira evropiane, të qëndrueshme në pronësi dhe menaxhuar nga vetë Kosovaret. Ai po ashtu ju dorëzoi një dosje me materiale për planet, strukturën, standardet etj. të gjithë anëtarëve të komisionit e cila përfshinte: një pamflet të punës dhe synimeve të ZAP, pjesët përkatëse apo relevante të neneve të Kushtetutës, ligjin aktual që e rregullon ZAP, strukturën organizative, raportin e parë të performancës, etj.

Sa i përket raporteve z. Lage tha se janë vendosur raporte mbi shumë shpenzues buxhetorë, diku rreth 25 prej tyre dhe dy mënyra tjera të auditimit të performancës i cili është i përqendruar te çështjet më të rëndësishme. Reagimet e këtyre raporteve kanë qenë të mira. Pothuajse të gjithë shpenzuesit buxhetorë kanë përpiluar një planë veprimi ku do ti adresojnë rekomandimet të cilat ne ua kemi dërguar atyre.

Ndërsa plani i punës i cili duhet të bashkërendohet me komisionin, Z. Lage tha se për shpenzuesit buxhetorë ne jemi duke e kryer një auditim të ri i cili quhet auditimi periodik, dhe sa kemi filluar të bëjmë auditimin e pasqyrave financiare dhe atë të menaxhmentit të shpenzuesve buxhetorë prej vitit 2009, kur do të përfundojë në vjeshtë të 2010. Deri me 8 janar ne do të jemi në gjendje të prodhojmë 35 deri 40 raporte të auditimit, një numër më i madh krahasuar me vitin e kaluar, në vitin 2010 e edhe më herët

Këtë vit kompanitë private do të shfrytëzohen që të kryejnë auditimin e diku 27 apo 28 komunave në Kosovë. Kompanitë audituese KPMG dhe Deloit janë duke i finalizuar raportet e tyre audituese për komuna dhe do të ju japim një raport gjithëpërfshirës mbi buxhetin e konsoliduar të komunave.

Për 5 vitet e ardhshme Kosova e ka një marrëveshje me Bashkësinë Evropiane që të rriten resurset humane të kësaj zyre për 20% çdo vit, kjo nuk është materializuar ende. Kjo është sfide kur jeni duke u përpjekur që të zhvillojmë një organizatë të qëndrueshme. Kemi marrë buxhet për 90 punonjës të cilët punojnë brenda kësaj organizate, jemi përpjekur që me rishikim 6 mujorë të buxhetit që të rritet numri i punonjësve deri në 106. Ky vendim është marrë nga Kuvendi 5 muaj më vonë me 24 nëntor të vitit 2009, pak a shumë është marrë vendimi kur ne veç gati kemi parashtruar kërkesën tonë buxhetore për vitin 2010, përmbajtja e kërkesës ka qenë të rritet në 106 numri i punonjësve brenda ZAP. Shpresojmë që vendimet të cilat do të merren do të jenë pozitive, jo vetëm të aprovohet numri i punonjësve por të aprovohet edhe buxheti për të paguar këta punonjës.

Buxheti i propozuar nga qeveria nuk i mbulon shpenzimet për pagat e punonjësve të cilët do të punojnë në ZAP. Dialogu për buxhetin i cili është zhvilluar midis meje dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa nuk ka shkuar ashtu si duhet. Raporti i performancës nuk është diskutuar në thellësi, ri-shikimi 6 mujorë nuk është rishikuar me të vërtetë, asgjë nuk është thënë dhe diskutimet mbi buxhetin tonë për vitin 2010 nuk janë përfunduar.

Ai gjithashtu i bëri thirrje komisionit që të përzgjedhë auditorët që do të auditojnë ZAP-in. Me përfundimin e raportit e performancës në prill të vitit 2010 ai duhet ti përmbajë pasqyrat tona financiare vjetore që është kryer auditimi pas të hyrave tona financiare, procesi i prokurimit ka filluar. Unë me të vërtetë do të dëshiroja nga ky komision që të caktoj auditorin specifik që të na auditojë, sepse unë nuk dëshirojë ti caktojë auditorët e mi.

Ai shtoi se mungon një mekanizëm i cili është shumë i rëndësishëm për ndërtimin e qeverisjes së mirë në Kosovë, dhe ajo është që ky komision dhe ky Kuvend në mënyrë më të fuqishme të merr parasysh se si është bërë shpenzimi i buxhetit. Prandaj ka propozuar ndryshime apo amandamentime te Ligjit mbi Financat Publike dhe Përgjegjësive. Mirëpo amandamentimet e këtij ligji janë vendosur në pritje. Ky komision dhe Kuvendi në përgjithësi duhet të bëjë presion tek qeveria dhe organizatat tjera buxhetore për financat publike, marrjen parasysh të rekomandimeve të ZAP, facilitimin e nevojave të ZAP etj.

Mbledhja përfundoi në 12:50

**Kryesuesi i Komisionit,**

---

**Haki SHATRI**